Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

SHDPAK
FONDACIONI SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

United Nations
ALBANIA

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Leave No One Behind

LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

@ UNDP
Tiranë, Korrik 2018

Përgatitur nga **FShDPAK**

Ndalohet shitja apo përdorimi i këtij materiali për qëllime përfitimi

Ky material u realizua përmes programit **“Askush të mos mbetet pas”**, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim, SDC, dhe zbatuar nga UNDP, UNICEF, UN Women and UNFPA.
Mendimet e shprehura në këtë guidë i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP.

Disa nga figurat e këtij materiali, janë prodhuar nga "Inspired Services Publishing" Ltd.

- Diskriminim do të thotë që dikush ju trajton keq ose në mënyrë të padrejtë vetëm sepse keni aftësi të kufizuar.

- Diskriminim do të thotë të sillesh keq ose padrejtësisht me një person edhe për arsye të tjera, si për shembull të trajtohesh keq vetëm sepse je grua apo sepse je Rom.



- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendos disa rregulla që nuk lejojnë që njerëzit apo qeveria t'ju trajtojë keq apo në mënyrë të padrejtë, pavarësisht se jeni person me aftësi të kufizuara, grua, Rom apo pjesë të ndonjë grupi tjetër.

- Trajtimi i keq, për shembull mund të jetë kur nuk ju lejojnë të futeni në një spital, në një qendër, restorant apo në ndonjë zyrë ose kur nuk ju pranojnë në shkollë ose nuk ju marrin në punë sepse keni aftësi të kufizuar.

- Qëllimi i ligjit është që të gjithë njerëzit të trajtohen në mënyrë të barabartë, pra njësoj pavarësisht aftësisë së kufizuar që mund të kenë.

- Kjo do të thotë që të gjitha të drejtat që kanë njerëzit, i kanë edhe personat me aftësi të kufizuara dhe duhet t'i gëzojnë këto të drejta, si për shembull, të drejtën për të votuar, për të punuar, për të qënë i lirë, për të lëvizur, njësoj si të gjitha të tjerët.

- Të trajtohesh në mënyrë të barabartë do të thotë që të kesh mundësi të njëjta për të bërë gjërat që dëshiron dhe mund të bësh.

- Disa njerëz kanë nevojë për më shumë ndihmë që të bëjnë gjërat që ata dëshirojnë të bëjnë.



- Ndonjëherë ka nevojë që njerëzit apo qeveria të bëjë ndryshime në mënyrë që të trajtoheni në mënyrë të barabartë.

- Kjo është e vështirë për t'u bërë ndonjëherë për njerëzit apo për qeverinë sepse mund të kërkojnë shpenzimin e parave. Kur kjo është shumë e vështirë apo e pamundur, quhet barrë e tepruar dhe njerëzit që kanë detyrë për të bërë këto ndryshime duhet të provojnë që e kanë shumë të vështirë ose të pamundur për t'i bërë këto ndryshime.

- Ndonjëherë këto ndryshime mund të jenë edhe të vogla, si për shembull lëvizja e mobiljeve në zyrë që një person me karrike me rrota të lëvizë lirshëm, pa pengesa.

- Një person që nuk shikon mund të ketë nevojë për ndihmë dhe mund të ketë nevojë për një tjetër person që e ndihmon ose për një kompjuter që lexon me zë të lartë.

- Ligji ju mbron ju nga diskriminimi, pra nga trajtimi jo i mire dhe i padrejtë në disa fusha.

Këto fusha janë:

- Punësimi

- Arsimi

- Shërbimet

- Ligji nuk lejon që të trajtoheni keq në vendin e punës ose të mos pranoheni në punë sepse keni aftësi të kufizuar.

- Nëqoftëse ju mund të bëni pjesën më të madhe dhe të rëndësishme të punës si të tjerët, atëherë ju duhet të keni mundësi si të tjerët për t'u punësuar në këtë punë.



- Personi që ju ka punësuar ose do t'ju punësojë ka detyrimin që t'ju japë këto mundësi. Personi që ju ka marrë ose do t'ju marrë në punë duhet ta bëjë të përshtatur ambjentin në zyrë, t'ju trajnojë, t'ju ndryshojë detyrat apo t'ju lejojë pushime herë pas here.

- Ligji ju mbron ju nga diskriminimi, pra nga trajtimi jo i mire dhe i padrejtë në disa fusha.



- Nëse ju i plotësoni kushtet për t'u pranuar në shkollë, shkolla ka detyrimin për të përshtatur ambjentin e saj, për të siguruar që ju merrni pjesë në mësim njësoj si të tjerët dhe për të marrë informacionin njësoj si shokët e tjerë.

- Kjo mund të thotë që informacioni duhet t'ju jepet juve në mënyrë të qartë dhe të thjeshtuar, të keni kompjuter që t'ju ndihmojë gjatë mësimit, të keni përkthim në gjuhën e shenjave nëse nuk dëgjoni, të keni kohë më shumë se sa të tjerët kur jepni një provim më shkrim apo me gojë.

- Ligji nuk lejon që të trajtoheni keq ose në mënyrë të padrejtë kur merrni shërbime apo kur bleni gjëra, si për shembull, në dyqane, banka, restorante, qendra sociale, kinema, zyra shtetërore apo të tjera.

- Ligji lejon që mund të trajtoheni me masa pozitive, si për shembull të keni përparësi ose favore në punësim. Kjo është e lejueshme dhe quhet trajtimi i ndryshëm i përligjur.

  Ky trajtim bëhet për t'ju ndihmuar dhe për të arritur barazinë.

Nëse jeni trajtuar keq ose në mënyrë të padrejtë sepse jeni person me aftësi të kufizuar, mund të ankoheni te:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:
Mund të telefoni pa pagesë në numrin: **0 8 000 606**

Tiranë:
Adresa: Rr: Sami Frashëri, Nr 10, Kati II, Tiranë
Kodi Postar: **1019** Tel: **+ 355 4 243 1078**
E-mail: **info@kmd.al**

Shkodër:
Adresa: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1
Kodi Postar: **4001** Tel: **+ 355 4 243 1078**
E-mail: **info@kmd.al**

Gjirokastër
Adresa: Ish "Shtëpia e Oficerave" ADISA, Gjirokastër
Kodi Postar: **6001** Tel: **+ 355 4 243 1078**
E-mail: **info@kmd.al**

Korçë
Adresa: Pranë Bashkisë Korçë, Rr:28 Nentori, Nr.1
Kodi Postar: **7001** Tel: **+ 355 4 243 1078**
E-mail: **info@kmd.al**

- Ligji parashikon që mund të drejtoheni edhe në Gjykatë ose në Prokurori.

- Ju mund të ankoheni te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjykatë dhe prokurori vetë ose përmes një organizate që mbron interesat tuaja.

SHDPAK
FONDACIONI
SHQIPËTAR
PËR TË DREJTAT
E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Adresa: Rr. Bogdani, Nr 1, Tiranë
Tel.: 0035542269426;
E-mail: adrf@albmail.com